



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i Biznesit - N.P. "Radio Rinia"
Numri i Biznesit: 810268418
Drejtor: Adem Limani
OSHMA: Radio Rinia
Adresa: Rr/ Skënderbeu p+13 kati 6.

Emri i Biznesit: "EMSALE" SH.P.K
NUI: 810854663
Pronari: Emanuel Demaj
Adresa: Rr/Pjetër Bogdani, T13-K2-nr.19, Tophane, Prishtinë

VENDIM

për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës të Radio Rinia, me seli në Komunën e Gjilanit



Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Rinia është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësorë të programeve të radios, me seli në komunën e Gjilanit. KPM, me datën 6 tetor 2009, i ka lëshuar licencën afatgjatë Radio Rinia, ndërsa me datën 6 tetor 2016, ka bërë ripërtëritjen e licencës edhe për një afat prej shtatë (7) vitesh.
3. Më datën 01 Gusht 2022, Radio Rinia ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Rinia nga N.P."Radio Rinia" me Numër Unik Identifikues (NUI) 810268418, me pronar z. Adem Limani tek biznesi "Emsale" SH.P.K, me Numër Unik Identifikues (NUI) 810854663, me pronar z. Emanuel Demaj.

Arsyetim

4. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së*".
5. Neni 15, paragrafi 2, pika 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "*Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të*

interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”

6. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
7. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë, pronari aktual i Radio Rinia ka deklaruar se arsye për këtë ndryshim është mos prezenca e tij në Kosovë, dhe nuk është në gjendje të menaxhoj siç duhet.
8. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të Radio Rinia, përmes një deklarate me shkrim, ka shprehur gatishmëri që ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
9. Komisioni konstaton se, kandidati përmes një plani të zgjeruar dhe detajuar të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka planifikuar zhvillimin e Radio Rinia përmes rritjes së cilësisë së programeve, transmetim të programeve për të gjitha grupet e moshave të shoqërisë, me theks të veçantë të programeve për fëmijët, si emisione me interes për publikun. Radio Rinia përmes planit të biznesit ka paraparë investime në trajnimin e stafit si dhe investime në teknologjinë e transmetimit, ndërsa sa i përket qëndrueshmërisë financiare ka bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare mbi shkallën dhe burimin e financimit.
10. Komisioni konstaton se, paraprakisht Radio Rinia nuk ka shlyer borxhin e vitit 2021, në shumën prej 1,000 eurosh dhe cilësohet si borxh i shkaktuar nga gjoba e vendosur nga KPM. Mirëpo, kandidati për pronarë të ri përmes një deklarate të nënshkruar është zotuar për marrjen përsipër të këtyre obligimeve financiare të Radio Shqip FM dhe shlyerjes së tyre brenda një afati të shkurt kohorë.
11. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiare, angazhimin e stafit profesional zotimet për rritjen e cilësisë dhe llojeve të programeve, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio Rinia është në interes të publikut.
12. Komisioni konstaton se, kërkesa për ndryshim të pronësisë të Radio Rinia është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

13. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 19 shtator 2022, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Rinia nga N.P.”Radio Rinia” me Numër Unik Identifikues (NUI) 810268418, me pronar z. Adem

Limani tek biznesi "Emsale" SH.P.K, me Numër Unik Identifikues (NUI) 810854663, me pronar z. Emanuel Demaj.

14. Përveç ndryshimit të pronësisë dhe bartjes së licencës të Radio Rinia nuk do të ketë ndryshime në pjesët tjera të Licencës, si Pjesës II – Parametrave Teknik, III – Formatit të Programit dhe IV – Zonës së Mbulimit.

15. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Xhevat Latifi

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



26.09.2022

datë

Wojli i dërgesës 839/
Vrsta postiljke

Vlera e cekur - Shuma e dërguar
Dënimtara vlerë - postatimim

nën numër
pod br.

z. EMANUEI DENAJ / "EMSALE" SH.P.K

Rr/ Pjetër Bagollari TAB-KC2-NR/19
(Vendi - Mesto)

Tophane Post Office

Postë i nënshkruari deklaron që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar më datë)

Dole potpiseni izjaviti je da le pomenute postiljke
postatimim) pridata vlerë - dënimtara

Nënshkrimi i marrësit
Potpis primaoca

Vula e postës së vendit
Pечат poste

Nënshkrimi i nëpunësit
të postës së vendit
Potpis radnika poste